



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio nr.147/2021

Gjuha e urrejtjes në tekstet shkollore të ciklit të ulët në Kosovë

Për: Znj. Arbërie Nagavci, ministre
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Kopje: Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, 11 gusht 2023

I. QËLLIMI I RAPORTIT

Ky raport ka për qëllim hulumtimin dhe analizimin e gjuhës së urrejtjes e përdorur në tekstet shkollore të arsimit fillor¹ dhe të arsimit të mesëm të ulët² (në tekstin e mëtejshëm: arsimit fillor) në sistemin arsimor në Republikën e Kosovës. Raporti është hartuar duke analizuar gjithsej 47³ tekste shkollore që përdoren si mjete mësimore në shkolla në Republikën e Kosovës, nga klasa e parë deri në të nëntën.

¹ Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2.: “Niveli 1: Arsimit fillor që zgjat 5 vite (normalisht prej moshës gjashtë (6) vjeçare, pjesa e mbetur e fazës 1 dhe 2 e KKK).”

² Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3.: “Niveli 2: Arsimit i mesëm i ulët që zgjat katër (4) vite (normalisht prej moshës dymbëdhjetë (12) vjeçare, faza 3 dhe 4 e KKK).”

³ Demaj, Frashër. *Historia 6- Fletore Pune*. Pejë: Dukagjini. 2021; Demaj, Frashër. *Historia 6*. Pejë: Dukagjini. 2021; Demaj, Frashër. *Historia 7- Fletore Pune*. Prishtinë: Dukagjini. 2021; Demaj, Frashër. *Historia 7*. Pejë: Dukagjini, 2021; Demaj, Frashër. *Historia 8*. Prishtinë: Dukagjini. 2021; Demaj, Frashër. *Historia 8- Fletore Pune*. Prishtinë: Dukagjini. 2021; Gashi, Agron. Saranda Kumnova (Pozhegu). Dhurata Tara – Nixha. Fatmir Fejziu. *Gjuhë Shqipe 3b – Fletore Pune*. Pejë: Dukagjini. 2021; Gashi, Agron. Saranda Kumnova (Pozhegu). Dhurata Tara – Nixha. Fatmir Fejziu. *Gjuhë Shqipe 3a-Fletore Pune*. Pejë: Dukagjini. 2021; Gashi, Agron. Saranda Kumnova (Pozhegu). Fatmir Fejziu. Dhurata Tara – Nixha. *Gjuhë Shqipe 4a – Fletore Pune*. Prishtinë: Dukagjini. 2021; Gashi, Agron. Saranda Kumnova (Pozhegu). Fatmir Fejziu. Dhurata Tara- Nixha. *Gjuhë Shqipe 4*. Prishtinë: Dukagjini. 2022; Gjokutaj, Mimoza. Laura Shuteriqi. Tereza Babasuli. Zana Sh. Saraqini, *Gjuhë Shqipe 3*. Prishtinë: Pegi. 2021; Gjokutaj, Mimoza (Çano). Saranda Kumnova (Pozhegu). Naser Zabeli. Tereza Babasuli (Basho). *Abetare*. Tranë: Pegi & Prishtinë: Dukagjini. 2022; Gjokutaj, Mimoza (Çano). Saranda Kumnova (Pozhegu). Naser Zabeli. Tereza Babasuli (Basho). *Abetare - Fletore Pune*. Tranë: Pegi & Prishtinë: Dukagjini. 2022; Gjokutaj, Mimoza. Anila Mullahi. Flora Koleci. Tereza Babasuli *Gjuhë Shqipe 9*. Prishtinë: Pegi. 2021; Gjokutaj, Mimoza. Anila Mullahi. Tereza Babasuli. Ragip Gashi. *Gjuhë Shqipe 6*. Prishtinë: Pegi. 2021; Hoti, Demi. Naser Zabeli. Erlehta Mato. *Edukata Qytetare 6 - Fletore Pune*. Libri Shkollor. 2022; Hoti, Demi. Naser Zabeli. Erlehta Mato. *Edukata Qytetare 6 - Libri i mësuesit*. Libri Shkollor. 2022; Hoti, Demi. Naser Zabeli. Erlehta Mato. *Edukata Qytetare 6*. Libri Shkollor. 2022; Islamaj, Shefkije. *Gjuhë Shqipe 6 - Libri i mësuesit*. Prishtinë: Libri Shkollor. 2022; Islamaj, Shefkije. *Gjuhë Shqipe 6*. Prishtinë: Libri Shkollor. 2022; Jashari, Ali. Osman Gashi. Saranda Kumnova (Pozhegu). Adriola Kanakçiu. Fatmir Fejziu. *Gjuhë Shqipe 5A- Fletore Pune*. Prishtinë: Dukagjini. 2021; Jashari, Ali. Osman Gashi, Saranda Kumnova (Pozhegu). Adriola Kanakçiu. Fatmir Fejziu. *Gjuhë Shqipe 5B- Fletore Pune*. Prishtinë: Dukagjini. 2021; Krasniqi, Shemsi. Sheribane Ibrahimaj Bahtiri. *Edukata Qytetare 7*. Prishtinë: Dukagjini. 2020; Krasniqi, Shemsi. Sheribane Ibrahimaj Bahtiri. *Edukata Qytetare 7- Fletore Pune*. Prishtinë: Dukagjini. 2020; Lutaj, Lindita. Dhurata Tara - Nixha. Miranda Stavileci. *Shoqëria dhe Mjedisit 1*. Prishtinë: Dukagjini. 2021; Lutaj, Lindita. Dhurata Tara - Nixha. Miranda Stavileci. *Shoqëria dhe Mjedisit 1- Fletore Pune*. Prishtinë: Dukagjini. 2021; Lutaj, Lindita. Dhurata Tara - Nixha. Miranda Stavileci. *Shoqëria dhe Mjedisit 2*. Prishtinë: Dukagjini. 2021; Lutaj, Lindita. Dhurata Tara - Nixha. Miranda Stavileci. *Shoqëria dhe Mjedisit 2 - Fletore Pune*. Dukagjini. 2021; Lutaj, Lindita. Dhurata Tara - Nixha. Miranda Stavileci. *Shoqëria dhe Mjedisit 3*. Prishtinë: Dukagjini. 2021; Lutaj, Lindita. Dhurata Tara - Nixha. Miranda Stavileci. *Shoqëria dhe Mjedisit 3 - Fletore Pune*. Prishtinë: Dukagjini. 2021; Mato, Erleta. Bajram Shatri. *Shoqëria dhe Mjedisit 3 - Libri i mësuesit*. Prishtinë: Libri Shkollor. 2022; Mato, Erleta. Bajram Shatri. *Shoqëria dhe Mjedisit 3*. Prishtinë: Libri Shkollor. 2022; Paçarizi, Rahman. Adelinë Selmani. Albulena Blakaj. *Gjuhë Shqipe 9a*. Prishtinë: Dukagjini. 2022; Paçarizi, Rahman. Adelinë Selmani. *Gjuhë Shqipe 7*. Prishtinë: Dukagjini. 2020; Paçarizi, Rahman. *Gjuhë Shqipe 7- Fletore Pune*. Pejë: Dukagjini. 2020; Paçarizi, Rahman. Saranda Kumnova (Pozhegu). Aurela Zisi. *Gjuhë Shqipe 2b- Fletore Pune*. Pejë: Dukagjini. 2021; Paçarizi, Rahman. Albulena Blakaj. Adelinë Selmani. *Gjuhë Shqipe 9b*. Prishtinë: Dukagjini. 2022; Paçarizi, Rahman. Saranda Kumnova Pozhegu. Aurela Zis. *Gjuha Shqipe 2a - Bashkë me fletore pune*. Prishtinë: Dukagjini. 2021; Rugova, Bardh. Atdhe Hykolli. *Libër leximi 1*. Prishtinë: Dukagjini. 2021; Rugova, Bardh. Shpëtim Elezi. Qëndresa Jakupi. Adelajda Baftiu. *Gjuhë Shqipe 6*. Pejë: Dukagjini. 2021; Rugova, Bardh. Shpëtim Elezi. Qëndresa Jakupi. Adelajda Baftiu. *Gjuhë Shqipe 6*. Prishtinë:

Nevoja për një hulumtim dhe raport të tillë, në radhë të parë vjen natyrshëm si rezultat i politikave globale për vetëdijesimin mbi gjuhën e urrejtjes dhe luftimin e saj deri në eliminim. Po ashtu vjen edhe si rezultat i nevojave të brendshme të shoqërisë në Kosovë, për të debatuar për tema të ndryshme dhe për probleme që cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Si shteti më i ri dhe një shoqëri që po ndërton një demokraci të mirëfilltë, Republika e Kosovës e ka shumë të nevojshme t'i testojë vazhdimisht kushtet dhe gjendjet e saj për sa u takon temave të tilla, si: liria e shprehjes apo e fjalës, barazia gjinore, mosdiskriminimi mbi baza të ndryshme, toleranca ndërfetare, diversiteti etnik dhe kulturor etj.

Deri sot, tekstet shkollore në përgjithësi në Kosovë kanë qenë temë diskutimi dhe subjekte analizimi nga shumë aktorë publikë dhe nga perspektiva të ndryshme. Por ky është një hulumtim specifik i teksteve shkollore i fokusuar vetëm te gjuha e urrejtjes dhe jo te aspektet e tjera didaktike, pedagogjike, profesionale etj.

II. KOMPETENCAT E AVOKATIT TË POPULLIT

1. Në përputhje me nenin 132 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.” Kushtetuta më tutje në nenin 135, paragrafi 3, parasheh: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”

2. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, Avokati i Popullit, ndër të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- “Për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit (neni 16, paragrafi 1);
- të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (neni 16, paragrafi 4);
- Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave (neni 16, paragrafi 8);

Dukagjini. 2021; Syla, Xhevat. *Gjuha Shqipe 1 - Libri i mësuësit*. Prishtinë: Libri Shkollor. 2022; Syla, Xhevat. *Gjuha Shqipe 1*. Prishtinë: Libri Shkollor. 2022; Tasho, Esmeralda. Vojsava Delijaj. Petrina Mataj. *Teknologji me TIK 9*. Tiranë: Irisoft Education. 2022; Tasho, Esmeralda. Vojsava Delijaj. Petrina Mataj. *Teknologji me TIK 9 - Fletore Pune*. Tiranë: Irisoft Education. 2022; Tasho, Esmeralda. Vojsava Delijaj. Petrina Mataj. *Teknologji me TIK 9 - Libër mësuësi*. Tiranë: Irisoft Education. 2022.

- *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, par. 1, nënpar. 1.2);*
- *t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.” (neni 18, par. 1, nënpar. 6).*

III. BURIMET DHE METODOLOGJIA

3. Tekstet shkollore janë burimi dhe mjete parësor i edukimit dhe i nxënies mësimore, në të gjitha sistemet arsimore. Duke qenë se tekstet që u ofrohen nxënësve në shkolla janë lexime obliguese për ta, ato janë burimet më kolektivisht të përdorura të informacionit dhe të edukimit të një komuniteti. Si të tilla, tekstet shkollore kanë ndikim të madh, gjithëpërfshirës dhe afatgjatë në edukimin kulturor dhe në formimin e mentalitetit të pjesëtarëve të një shoqërie. Për një pjesë të madhe të shoqërisë, pavarësisht shkollimit universitar të mëvonshëm dhe edukimeve profesionale formale dhe joformale, bazat e njohurive dhe dijet e marra gjatë shkollimit fillor dhe i mesëm mbesin themeli i edukimit gjatë tërë jetës. Kjo tregon rëndësinë jetike dhe përmasat totale afatgjata të teksteve shkollore në gjendjet dhe perspektivat e një shoqërie si dhe në vetë nivelet dhe karakteristikat e qytetërimit të asaj shoqërie. Andaj historikisht, shoqëritë dhe shtetet u kanë kushtuar shumë rëndësi teksteve shkollore, përkatësisht përmbajtjes së tyre dhe narracionit të përcjella nga to.⁴

4. Në thelb, tekstet shkollore janë libra specifikë të planifikuar, të hartuar, të miratuar dhe të përfshirë për përdorim nëpër shkolla nga institucionet e një shteti, në shërbim të edukimit formal dhe përcjelljes së dijeve të caktuara te nxënësit në sistemin arsimor publik të atij vendi. Në Republikën e Kosovës, ky funksion ushtrohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (në tekstin e mëtejme: MASHTI). Në Ligjin Nr. 02/L-67 për Botimin e Teksteve Shkollore, Mjeteve Mësimore, Lektyrës Shkollore dhe Dokumentacionit Pedagogjik (në tekstin e më tejme: Ligji për tekstet shkollore)⁵, në nenin 1 ka përcaktuar: *“Teksti shkollor” për shkolla fillore, shkolla të mesme të ulëta dhe për shkolla të mesme të larta është libër themelor dhe i obligueshëm që shërben si mjet themelor dhe burim i dijes për fushën e caktuar dhe me përdorimin e të cilit arrihen objektivat edukativo-arsimorë të përfshira në plan dhe program mësimor. Teksti shkollor është i hartuar në bazë të planit dhe të programit mësimor dhe i formësuar në pikëpamje didaktike, duke marrë parasysh aftësitë psikofizike të nxënësve dhe veçoritë e lëndës mësimore. [...].”*

5. Duke qenë se në Kosovë është ngritur një sistem arsimor publik në gjuhën shqipe vetëm në gjysmën e dytë të shekullit XX, tradita e teksteve shkollore është e vonë dhe e kultivuar me shumë vështirësi, për arsye të një konteksti historik kompleks që ka përcaktuar historinë e arsimit në gjuhën shqipe në Kosovë.⁶ Pas luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë, tekstet shkollore janë ndryshuar, përpunuar dhe avancuar, në kuadër të ngritjes së një sistemi arsimor publik krejt të ri, fillimisht nga institucionet e përkohshme vetëqeverisëse dhe pas vitit 2008

⁴ Eckhardt Fuchs & Kathrin Henne, *“History of Textbooks Research”*, in Fuchs. E., Bock. A., (eds), *The Palgrave Handbook of Textbooks Studies*, New York: Palgrave Macmillan, 2018, pp. 25-56.

⁵ Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë :viti II / nr. 9 / 01 shkurt 2007, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2437>.

⁶ Bajram Shatri, *Arsimi dhe shkollat e mesme në Kosovë në shekullin XX*, Prishtinë: Libri Shkollor, 2019.

nga ato të Republikës së Kosovës. Së fundmi, kurrikula e re shkollore ka hyrë në fuqi në vitin 2017, por nxënësit nuk i kanë marrë tekstet e reja shkollore të rishikuara deri në fillimin e vitit shkollor 2019/2020.⁷

6. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit ka analizuar gjuhën e teksteve shkollore në Kosovë dhe veçanërisht gjendjen e tyre në raport me gjuhën e urrejtjes, si një koncept i veçantë në diskursin publik. Për realizimin e hulumtimit janë përdorur tri lloj burimesh: Burime parësore të literaturës: 47 tekste shkollore që janë në përdorim në ciklin e ulët në sistemin arsimor në Republikën e Kosovës; Burime teorike: studime teorike mbi gjuhën e urrejtjes si dhe studime e raporte mbi tekstet shkollore në Kosovë; Burime legjislativë: dokumente ligjore vendore dhe ndërkombëtare për gjuhën e urrejtjes dhe gjithë çfarë përfshin ky koncept.

7. Duke qenë se ky raport është produkt i një hulumtimi që analizon tekste shkollore, natyrshëm e tërë metodologjia e punës për realizimin e tij është teorike. Metodologjia e ndjekur për të arritur deri te ky raport është ajo që njihet si analizë teksti (*textual analysis*). Kjo nënkupton që gjatë analizimit të teksteve shkollore, ato u janë nënshtruar një kritike të retorikës së tyre, analizimit të përmbajtjes, analizimit të ndërveprimit të tekstit si dhe studimit të performancës së tekstit si dialog me publikun lexues.⁸ Gjithashtu, duke qenë se ky hulumtim është i përqendruar te gjuha e urrejtjes, meqë format e saj mund të jenë edhe joverbale, në këtë raport janë analizuar edhe ilustrimet e teksteve shkollore. Kjo përfshin tërë ikonografinë e teksteve shkollore, si: fotografitë, hartat, vizatimet ilustruese dhe gjithçka që paraqet imazh brenda këtyre teksteve shkollore, i është nënshtruar një leximi semiotik për format e prodhimit të kuptimeve sipas metodës së analizës vizuale (*visual analysis*).⁹ Për t'i analizuar përmbajtjen dhe imazhet e teksteve shkollore, atyre u është bërë një lexim kritik i dyfishtë, duke kaluar dy herë nëpër lexime faqe pas faqeje dhe duke u lexuar, parë dhe riparë e tërë përmbajtja e tyre tekstuale dhe ikonografike.

IV. GJUHA E URREJTJES: TEORITË DHE LIGJET

8. Përkundër përdorimit të shpeshtë të termit “gjuhë e urrejtjes” në raporte ndërkombëtare, studime të ndryshme të shkencave shoqërore, legjisllacion, procese gjyqësore, media, parlamente dhe diskutime të ndryshme për diskursin publik, nuk ka një përkufizim gjithëpërfshirës apo të pranuar gjerësisht për atë se çka është gjuha e urrejtjes. Ky term paraqet një koncept prej të cilit rrjedhin shumë kuptime dhe trajta të gjuhës së urrejtjes, që e tejkalojnë kuptimin e parë të drejtpërdrejtë të fjalës. Termi gjuhë e urrejtjes përmban shumë shtresa me ngarkesa kuptimore që lidhen kryesisht me shprehjen dhe nxitjen e urrejtjes, të ksenofobisë, të diskriminimit mbi baza gjinore, racore, fetare, etnike, të orientimit seksual apo tjetër, si dhe me mosdurimin dhe mostolerancën ndaj tjetrit apo ndaj komuniteteve të caktuara. Sipas fjalorit të Kembrixhit, gjuha e urrejtjes përkufizohet si: “*të folurit publik që*

⁷ Kallxo, Tekstet e reja shkollore në vitin e ri shkollor, 2019, në: <https://kallxo.com/shkurt/tekstet-e-reja-shkollore-ne-vitin-e-ri-shkollor/>.

⁸ Lawrence R. Frey, C. Botan, G. Kreps, *Investigating Communication: An Introduction to Research Method*, London: Pearson, 1999, pp. 281-285.

⁹ Philip Bell, *Content analysis of visual images*, in Leeuwen Th., Jewitt C., eds., *Handbook of Visual Analysis*, London: Sage Publications, 2004, pp. 10-22.

shpreh urrejtje ose inkurajon dhunë ndaj një personi apo grupi, bazuar në diçka të tillë si raca, feja, seksi ose orientimi seksual.”¹⁰

9. Si një organizatë për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit në Evropë, Këshilli i Evropës është institucioni që mbase më së shumti ka hartuar dokumente dhe nisur politika për ta luftuar gjuhën e urrejtjes. Në Rekomandimin Nr. R 97(20) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për “gjuhën e urrejtjes”, i datës 30 tetor 1997, ishte dhënë ky përkufizim: *“Termi “gjuhë urrejtjeje” kuptohet ashtu që mbulon të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, mbështesin apo justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera urrejtjeje të bazuara në intolerancë, duke përfshirë: intolerancën e shprehur nga nacionalizmi agresiv dhe etnocentrizmi, diskriminimi dhe armiqësinë ndaj minoriteteve, emigrantëve dhe njerëzve me origjinë emigrante. Në këtë kuptim, “gjuha e urrejtjes” mbulon komentet të cilat domosdoshmërisht janë të drejtuar kundër një personi ose një grupi të caktuar personash.”¹¹*

10. Në një nga dokumentet më të referuara nga të gjitha studimet dhe hulumtimet për gjuhën e urrejtjes, i titulluar “Doracak për gjuhën e urrejtjes” (“Manual on Hate Speech”)¹², autorja Weber e ka trajtuar gjuhën e urrejtjes, duke renditur një mori dokumentesh dhe institucionesh që në forma të ndryshme e kanë për subjekt gjuhën e urrejtjes apo dimensione të caktuara të saj, siç janë: Këshilli i Evropës; Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; Karta Sociale Evropiane; Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; Deklarata Universale për të Drejtave të Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet saj; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkrimin e Krimit të Gjenocidit; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave; Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian etj. Sipas doracakut, termi “gjuhë e urrejtjes” përdoret edhe në jurisprudencën evropiane, megjithëse gjykata asnjëherë nuk e ka përkufizuar në ndonjë përkufizim fiks këtë term. Anne Weber vëren: *“Gjykata thjesht i referohet në disa nga vendimet e saj “të gjitha formave të shprehjes që përhapin, nxisin, mbështesin apo justifikojnë urrejtjen e bazuar në intolerancë (përfshirë intolerancën fetare). Është e rëndësishme të theksohet se ky është një koncept “autonom”, për aq sa Gjykata nuk e konsideron veten të detyruar nga gjykatat vendase.”* Për pasojë, ajo ndonjëherë hedh poshtë klasifikimet e miratuara nga gjykatat kombëtare ose, përkundrazi, i klasifikon deklaratat e caktuara si “gjuhë urrejtjeje”, edhe kur gjykatat vendëse e përjashtuan këtë klasifikim. Koncepti i “gjuhës së urrejtjes” përfshin një sërë situatash: së pari, nxitja e urrejtjes racore, ose me fjalë të tjera, urrejtja e drejtuar kundër personave ose grupeve të personave për shkak se i përkasin një race; së dyti, nxitja e urrejtjes për arsye fetare, me të cilën mund të barazohet nxitja e urrejtjes në bazë të dallimit ndërmjet besimtarëve dhe jobesimtarëve; së fundmi, për ta përdorur formulimin për “gjuhën e urrejtjes” të Rekomandimit të Komitetit të Ministrave të

¹⁰ Hate Speech, Cambridge Dictionary, in <https://dictionary.cambridge.org/us/dictionary/english/hate-speech> (see on: 04.06.2023); orig.: “public speech that expresses hate or encourages violence towards a person or group based on something such as race, religion, sex, or sexual orientation”.

¹¹ Recommendation CM/Rec(2022)16[1] of the Committee of Ministers to member States on combating hate speech in <https://shorturl.at/qGLST> (accessed: 05.06.2023).

¹² Anne Weber, *Manual on Hate Speech*, Strasbourg: Council of Europe, Publishing Editions, 2009.

Këshillit të Evropës, nxitjen e formave të tjera të urrejtjes bazuar në intolerancën “e shprehur nga nacionalizmi agresiv dhe etnocentrizmi”.¹³

11. Në këtë vit, pra më 2023, Organizata për Kulturë, Shkencë dhe Arsim e Kombeve të Bashkuara - UNESCO, publikoi udhëzuesin “Trajtimi i gjuhës së urrejtjes përmes arsimit: Një udhëzues për politikbërësit” - UNESCO 2030. Në thelb, ky dokument për trajtimin e gjuhës së urrejtjes nëpërmjet arsimit nënkupton përfundimin e kapaciteteve të sistemeve dhe të institucioneve arsimore si dhe të mësimit, për të ofruar mjedise gjithëpërfshirëse të të mësuarit ku respektohen të drejtat e njeriut, pa urrejtje, pa diskriminime dhe pa paragjykitje, në mbështetje të identiteteve, të kulturave, të besimeve dhe të kombeve të ndryshme. Udhëzuesi ofron rekomandime konkrete për politikbërësit për ta trajtuar gjuhën e urrejtjes dhe për t’i zbutur ndikimet mbi ata që janë në shënjestër, përmes strategjive që përqendrohen, ndër të tjerash, në kurrikulat dhe në tekstet shkollorë, në pedagogjinë, në edukimin e mësuesve, në menaxhimin e institucioneve arsimore dhe partneritetet. Një qasje e kombinuar e ndërhyrjeve sistematike dhe të njëkohshme, në të gjitha ato fusha, është çelësi për ta trajtuar në mënyrë të efektshme gjuhën e urrejtjes dhe për t’i bërë shoqëritë më elastike ndaj shprehjeve çnjerëzore të urrejtjes. Nëpërmjet këtij dokumenti, UNESCO-ja ofron 12 rekomandime për ta trajtuar gjuhën e urrejtjes nëpërmjet arsimit, si më poshtë:

- *“Jepini përparësi çështjes së gjuhës së urrejtjes dhe ndërmerri veprime për ta kundërshtuar atë me plane konkrete zbatimi, duke përfshirë kornizat e politikave dhe shpërndarjen buxhetore.*
- *Integroni përpjekjet për të luftuar gjuhën e urrejtjes në nismat ekzistuese të sektorit të arsimit për të siguruar një qasje të shëndetshme ndaj çështjes.*
- *Sigurohuni që strategjitë për të trajtuar gjuhën e urrejtjes mbështesin të drejtën e lirisë së shprehjes.*
- *Krijoni dhe zbatoni udhëzime dhe mekanizma të qarta për të mbështetur individët dhe grupet e shënjestruara nga gjuha e urrejtjes në mjediset arsimore, duke përfshirë mekanizma dhe norma të qarta raportimi për pajtueshmërinë dhe zbatimin.*
- *Përfshini në kurrikulën formale aktivitete arsimore për të trajtuar shkaktuesit rrënjësor të gjuhës së urrejtjes, duke i kushtuar vëmendje të veçantë pabarazive historike dhe bashkëkohore.*
- *Krijoni dhe përditësoni vazhdimisht kurrikulat mbi edukimin mediatik dhe informativ dhe qytetarinë digjitale.*
- *Përfshini në kurrikula aktivitetet edukative për të forcuar aftësitë e të menduarit kritik, të mësuarit social dhe emocional, dialogun ndërkulturor dhe qytetarinë globale për të nxitur ndryshimin e nevojshëm të sjelljes pro-sociale, për të luftuar gjuhën e urrejtjes dhe për të mbështetur gjithëpërfshirjen dhe diversitetin.*
- *Inkurajoni aktivitetet jashtëshkollorë që nxisin të menduarit kritik dhe dialogun ndërkulturor dhe mund të kontribuojnë në një mjedis gjithëpërfshirës.*

¹³ Anne Weber, *Manual on Hate Speech*, Strasbourg: Council of Europe, Publishing Editions, 2009, p. 10, in https://www.google.com/books/edition/Manual_on_hate_speech/9pPjBAAAQBAJ?hl=en&gbpv=1&dq=anne+weber+manual+on+hate+speech&printsec=frontcover

- *Zhvilloni dhe zbatoni mekanizma për të inkurajuar dhe aftësuar shkollat për të siguruar që klima e të mësuarit në klasë është e sigurt, respektuese dhe gjithëpërfshirëse, për t'u bërë modele të diversitetit dhe gjithëpërfshirjes, dhe për të kultivuar një qasje të përfshirjes së të gjithë shkollës në përpjekjet për të trajtuar gjuhën e urrejtjes.*
- *Ofroni edukatorëve dhe drejtuesve të shkollave trajnime të vazhdueshme për t'i pajisur ata me qasje të reja arsimore për t'iu përgjigjur dhe luftuar gjuhës së urrejtjes në aktivitetet e tyre të përditshme dhe ndërveprimet me nxënësit.*
- *Ndërtoni elasticitetin e sistemeve arsimore përmes një përpjekjeje të integruar, duke përfshirë në të kontaktin me familjen dhe komunitetin dhe partneritetin e shumë palëve.*
- *Vendosni kritere për të qasur dhe vlerësuar efektivitetin e ndërhyrjeve për të adresuar gjuhën e urrejtjes.”¹⁴*

12. Këto rekomandime të UNESCO-s shkojnë për të gjithë politikbërësit në botë që nëpërmjet arsimit duan ta trajtojnë dhe eliminojnë gjuhën e urrejtjes në të gjitha format e manifestimit të saj në shoqëri. E thënë në mënyrë të përgjithshme, të gjitha dokumentet ligjore ndërkombëtare për liritë e të drejtat e njeriut dhe ato kundër formave të ndryshme të diskriminimit dhe të pabarazisë, përmbajnë nene dhe norma që vendosin konture që trajtojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi gjuhën e urrejtjes.

13. Dokumenti i parë ndërkombëtar që në mënyrë të drejtpërdrejtë ka trajtuar gjuhën e urrejtjes, ka qenë Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, që është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, e cila në nenin 4 ka përcaktuar:

“Shtetet palë dënojnë çdo propagandë dhe të gjitha organizatat të bazuara në idetë ose teoritë e epërsisë së një race apo të një grupi personash të një ngjyre apo origjine etnike të caktuar, ose të cilat përpiqen të justifikojnë atë e të ndihmojnë çdo formë të urrejtjes e të diskriminimit racial; ato zotohen të marrin masa të menjëhershme dhe pozitive për të zhdukur çdo nxitje për një diskriminim të tillë ose akt diskriminues dhe për këtë qëllim, duke mbajtur parasysh, si duhet, parimet e shprehura në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe të drejtat e shpallura posaçërisht në nenin 5 të kësaj Konvente, ato zotohen konkretisht:

(a) Të shpallin vepra të dënueshme me ligj çdo përhapje të ideve të bazuara në epërsinë ose urrejtjen raciale, çdo nxitje për diskriminim racial, si dhe çdo akt dhune, ose provokim për kryerjen e akteve të kësaj natyre kundër çdo race apo grupi personash të një ngjyre ose origjine tjetër etnike, si dhe ndihmën e veprimtarive raciste, duke përfshirë këtu edhe financimin e tyre;

(b) Të shpallin të paligjshme dhe të ndalojnë organizatat si dhe veprimtaritë propagandistike të organizuara e çdo aktivitet tjetër propagandistik që ndihmon dhe nxit diskriminim racial dhe pjesëmarrjen në këto organizata dhe veprimtari të shpallin vepër të dënueshme me ligj;

¹⁴ UNESCO, *Addressing hate speech through education: A guide for policy-makers*, Paris: UNESCO, 2023, pp. 9-10, in: https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/publications-and-resources/Addressing_hate_speech_through_education_A_guide_for_policy_makers.pdf?fbclid=IwAR3Hzo95PL9B8GIKYtHmAzJD_FBWdoNCbYyeVT-eA0aLWcElkxbGwMHBuk0, (accessed: 05.06.2023).

(c) Të mos lejojnë autoritetet publike ose institucionet publike, qofshin ato kombëtare ose lokale, që ndihmojnë diskriminimin racial apo ta nxisin atë.”

14. Megjithëse Kosova nuk është anëtare e shumicës së organizatave ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara, nuk është nënshkruese e shumë prej konventave ndërkombëtare që trajtojnë gjuhën e urrejtjes, shteti i Kosovës ka adaptuar shumicën e ligjeve të vendeve të Bashkimit Evropian (BE) për këtë si dhe ka harmonizuar vazhdimisht ligjet e saj me frymën e ligjeve të BE-së. Që në aktin themeltar të shtetësisë së Kosovës, pra në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), Republika e Kosovës përkufizohet si shtet demokratik që *“bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirisë të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut”*¹⁵, si një shtet që e garanton lirinë e shprehjes, e cila sipas Kushtetutës *“mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.”*¹⁶

15. Tutje, neni 22 i Kushtetutës (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe i Instrumenteve Ndërkombëtare), i liston tetë marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare që Kosova i zbaton drejtpërdrejt dhe që kanë prioritet ndaj ligjeve vendore, e të cilat janë: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirisë Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; Konventa për të Drejtat e Fëmijës; Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese; Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje.¹⁷

16. Ligji nr. 05/l-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi,¹⁸ në nenin 3, paragrafi 1, përcakton: *“Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilëdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.”* Ndërsa neni 1, paragrafi 1, i këtij ligji përcakton: *“Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.”*

¹⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 7, paragrafi 1, Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2008, p. 2, in <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

¹⁶ Po aty, neni 40, paragrafi 2.

¹⁷ Po aty, neni 22.

¹⁸ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.16/26 qershor 2015, Prishtinë.

17. Për më tepër, Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës¹⁹, në nenin 27 (Edukimi dhe arsimimi), paragrafi 3, ka përcaktuar: “[...] Në procesin edukativ dhe arsimor, është e ndaluar të promovohet gjuha e urrejtjes, dhuna, jo toleranca, diskriminimi dhe format e tjera që nxisin konflikte ndër njerëzore.”

18. Përtej dispozitave të lartcekura, për sa i takon gjuhës së urrejtjes në tekstet shkollore në Kosovë, në rrafshin ligjor është me rëndësi të theksohet Ligji 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës²⁰, përkatësisht neni 1, paragrafi 2, ku përcaktohet: “[...] 2.3. zhvillimi i respektit të nxënësi për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe për parimet e përcaktuara me Kartën e Kombeve të Bashkuara, me konventat përkatëse dhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës; 2.4. zhvillimi i respektit të nxënësit për prindërit dhe mësimdhënësit, për identitetin kulturor, gjuhën dhe vlerat e komunitetit të tij, për vlerat e Republikës së Kosovës, për shtetin nga i cili mund të ketë prejardhjen dhe për respektimin e diversitetit; 2.5. përgatitja e nxënësit për jetesë të përgjegjshme në frymën e mirëkuptimit, të paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe në miqësi me pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës, e më gjerë; 2.6. të zhvillojë të nxënësi respektin për mjedisin.”

19. Tutje, Ligji për tekstet shkollore, në nenin 3 (Kërkesat që duhet t’i përmbushin tekstet shkollore, mjetet mësimore, lektura shkollore dhe dokumentacioni pedagogjik), paragrafi 3.2, përcakton: “Nuk lejohen tekstet shkollore, mjetet mësimore, lekturat shkollore dhe dokumentacioni pedagogjik që bëjnë propagandë kundër Kosovës, që cenojnë të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore dhe që nxisin urrejtje politike, nacionale dhe fetare.”

20. Dispozitat ligjore të lartcekura përcjellin frymën dhe përmbajtjen e ligjeve në Republikën e Kosovës, përmes të cilave mund të nxirret përfundimi se institucionet e Kosovës e kanë rregulluar sistemin publik arsimor duke pasur parasysh normat dhe vlerat ndërkombëtare të lirive dhe të të drejtave të njeriut, të lirisë së shprehjes dhe të rreziqeve nga të gjitha format e manifestimit të gjuhës së urrejtjes në diskursin publik.

V. ANALIZIMI I TEKSTEVE SHKOLLORE DHE GJETJET

21. Nga të gjitha tekstet shkollore, mbase teksti më simbolik në sistemin shkollor të ciklit të ulët është “Abetarja”, teksti prej të cilit nxënësit i mësojnë shkronjat e alfabetit dhe aftësohen të lexojnë në gjuhën amtare. Që nga vitit 2022, një abetare e përbashkët, e hartuar nga katër autorë, është futur në përdorim në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Shqipërisë, duke qenë që të dyja këto shtete banohen me shumicë nga populli shqiptar dhe e kanë gjuhë amtare shqipen. Andaj edhe gjetjet e hulumtimit që ka prodhuar këtë raport listohen duke u nisur pikërisht nga Abetarja. Si një libër themeltar, Abetarja nuk ka ndonjë përmbajtje që qartësisht do të mundë të cilësohej si gjuhë e urrejtjes apo nxitje drejt saj. Megjithatë, mosshfaqja e gjuhës së urrejtjes në forma proaktive nuk e përjashton mundësinë e krijimit të hapësirave boshe për krijimin e përshtypjeve për mungesa të caktuara, që mund të cilësohen si diskriminuese. Përveç një rasti në tekstin bazë dhe një tjetri në Fletoren e Punës të Abetares, ku në ilustrime mes fëmijësh shihen edhe fëmijë të racave të

¹⁹Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.14/17, korrik 2019, Prishtinë gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844.

²⁰ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (GZRK) më 16 shtator 2011

tjera (shih figurat nr. 1²¹ dhe nr. 2²²), në të gjitha ilustrimet e Abetares shihen vetëm fëmijë të bardhë. Në këtë pikëpamje, ilustrimet e Abetares mund të cilësohen si diskriminuese në rrafshin racor, meqë ato përfshijnë fare pak fëmijë që nga pamja e tyre janë të identifikueshëm si të racave të ndryshme. Mirëpo përtej kësaj, ilustrimet e tjera të Abetares dhe të Fletores së Punës së saj janë shembuj të mirë të promovimit të barazisë gjinore, me ilustrime të tilla ku në profesione që përgjithësisht perceptohen si mashkullore, hasen personazhe femërore, si në rastin e një policeje (shih Figurën 3²³) apo të një futbollisteje (shih Figurën 4²⁴), që të dyja në Fletoren e Punës të Abetares.



Figura 1.




Figura 2.



Figura 3.

²¹ Mimoza (Çano) Gjokutaj, Saranda Kumnova (Pozhegu). Naser Zabeli. Tereza Babasuli (Basho), *Abetare*. Tranë: Pegi & Prishtinë: Dukagjini, 2022, p. 84.

²² Mimoza (Çano) Gjokutaj, Saranda Kumnova (Pozhegu). Naser Zabeli. Tereza Babasuli (Basho), *Abetare.- Fletore Pune*, Tranë: Pegi & Prishtinë: Dukagjini, 2022, f.. 6.

²³ Po aty f. 138.

²⁴ Po aty f. 147.

ÇFARË KA JONA?

- Jona i _____ flokët të kuq.
- Jona _____ top futbollli.
- Jona _____ pantallona të shkurtra.
- Jona _____ bluzë me kapuç.
- Jona _____ atlete të zeza.



Figura 4.

Meqë në klasën e parë nxënësit ende nuk dinë të lexojnë, tekstet shkollore kanë më shumë ilustrime sesa përmbajtje tekstuale. Por tekstet shkollore të klasës fillestare duhet lavdëruar për ilustrimet e tyre të kujdesshme dhe të balancuara në aspektin gjinor të personazheve dhe për praninë e personave me aftësi të kufizuar. Kjo është e evidentuar edhe te teksti *Shoqëria dhe Mjedisi* i klasës së parë, ku sërish shihen vajza që luajnë futboll (shih Figurën 7²⁵), një fëmijë me aftësi të kufizuara në karrocë (shih Figurën 6²⁶) si dhe personazhe që kryejnë punë shtëpie të ndryshme dhe shpesh të kundërta në raport me stereotipat sociale (shih Figurën 5²⁷).



Figura 5.

²⁵ Lindita Lutaj, Dhurata Tara – Nixha, Miranda Stavileci, *Shoqëria dhe Mjedisi 1*, Prishtinë: Dukagjini. 2021, f. 9.

²⁶ Po aty f. 12.

²⁷ Po aty f. 44.

Me këto duar,
sa e sa herë mësuemes
hule i kam dhuruar!



Familja ime kujdeset për mua.

Me këto duar,
sa e sa herë rënë
ngrohë e kam përçafuar!



Ne kujdesemi për veten.



Ne jemi shokë dhe shoqe klase.



Unë i besoj shokut tim të
ngrohë dhe bashkë flasin
për shtetësit tona.



Të gjithë kemi nevojë për dashuri
dhe kujdesin e të tjerëve.



Tani po rritem dhe shumë gjëra
mund t'i bëj vetë.



Ne mësojmë së bashku.



Ne jemi shokë situadë.

Figura 6

Figura 7

Fëmijë me përkatësi të ndryshme racore, prania e personave me aftësi të kufizuara, si dhe përfshirja e personave të të dyja gjinive, janë ilustruar edhe në tekstin Shoqëria dhe Mjedisi i klasës së 2-të. Të tëra këto janë paraqitur në kontekste të caktuara që promovojnë barazinë mes njerëzve, sikur edhe ilustrimi i mëposhtëm të i cili personazhet Era dhe Drini thonë së bashku: “*Ne jemi nxënës të klasës së dytë. Ne jemi të ndryshëm, por të barabartë.*” (shih Figurën 8²⁸). Kjo fjali e vendosur si deklaratë e përbashkët në gojë të dyve, është një formë e edukimit të nxënësve për t’i pranuar diversitetin dhe barazinë mes njerëzve.

**Jemi të ngjashëm,
jemi të ndryshëm**

Unë, nevojat dhe dëshirat

Unë jam Era.

Unë jam Drini.

Ne jemi nxënës të klasës së dytë.
Jetojmë në Kosovë.
Ne jemi të ndryshëm, por të barabartë.

- Prezanto veten

Nevojat

Dëshirat

Figura 8

²⁸ Lindita Lutaj, Dhurata Tara – Nixha, Miranda Stavileci, *Shoqëria dhe Mjedisi 1*, Prishtinë: Dukagjini. 2021, f. 4.

22. Teksa nxënësit filloristë avancojnë në klasën e tretë, teksti shkollor i lëndës Shoqëria dhe Mjedisi vazhdon ta promovojë barazinë gjinore, sikurse në njësinë “Unë dhe ti - të barabartë”, duke krijuar një situatë ku hidhen poshtë stereotipat socialë për rolet gjinore, si në këtë rast duke atakuar një formë të tij: “Futbolli nuk është për vajza” (shih Figurën 9²⁹). Një njësi tjetër brenda këtij teksti flet për llojllojshmërinë e shoqërisë, përcjellë mësimet për diversitetin kulturor nëpërmjet një situatë imagjinare, ku Mati interviston Flakën dhe në pyetjen e tij: “Nga se ndryshojnë njerëzit?”, Flaka përgjigjet: “Njerëzit ndryshojnë nga përkatësia kombëtare apo etnike, gjuha që flasin, vendi ku jetojnë, nga besimet fetare etj.” Dialogu intervistues i tyre vazhdon tutje me pyetjen e Matit: “Cilët popuj jetojnë në Kosovë?” Kurse Flaka përgjigjet: “Në vendin tonë jetojnë popuj të ndryshëm, si shqiptarë, romë, boshnjakë, ashkali, serbë, turq etj.” (shih Figurën 10³⁰).



Figura 9



Figura 10

23. Njësi të tilla mësimore janë padyshim shembuj pozitivë të kultivimit të barazisë gjinore dhe të diversitetit etnik dhe kulturor brenda shoqërisë së Kosovës, që edhe formalisht si shtet është i përkufizuar si shtet multi-etnik. Kjo qasje dhe këto njësi në një fazë aq të hershme shkollimi si klasa e tretë, janë një mënyrë shumë e menduar mirë për edukimin e hershëm të brezave të rinj për t’i parë si të barabartë njerëzit me gjithë të përbashkëtat dhe dallimet e tyre si dhe për vetëdijesimin për strukturën multi-etnike të shoqërisë ku ata jetojnë.

24. Megjithatë, përfaqësuesit e organizatave të romëve, të ashkalinjve dhe egjiptianëve kanë ngritur si shqetësim mospërfshirjen dhe mosnjohjen e historisë dhe të kulturës së romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve në tekstet shkollore. Teksti i lartpërmendur ka elemente të gjuhës përjashtuese për faktin se nuk specifikohen dhe nuk përmenden komunitetet e tjera (ashkalinjtë, egjiptianët dhe goranët), të cilat jetojnë në Kosovë dhe për më shumë njihen

²⁹ Lindita Lutaj, Dhurata Tara - Nixha. Miranda Stavileci. *Shoqëria dhe Mjedisi 3*. Prishtinë: Dukagjini. 2021 f. 54.

³⁰ Po aty f.58

edhe si kategori kushtetuese.³¹ Sipas tyre, mungesa e këtyre narrativeve kontribuon në forcimin e stereotipave dhe paragjykimeve ekzistuese ndaj tyre.

25. Teksti shkollor Shoqëria dhe Mjedisi, i klasës së tretë, mund të jetë teksti me përmbajtjen më të shumtë me karakter edukativ për nxënësit në raport me barazinë mes njerëzve, diversitetin racor, etnik dhe kulturor, lirinë e shprehjes, bullizmin si dhe tolerancën në shoqëri. Kjo meqë ky tekst shkollor ka shumë njësi mësimore për grupet shoqërore, respektin reciprok, vlerat familjare, të drejtat dhe përgjegjësitë në shoqëri, ndalimin e dhunës, ruajtjen e traditës, respektimin dhe ruajtjen e natyrës, kujdesin për bimët dhe kafshët, llojllojshmërinë racore, kulturore dhe etnike, barazinë dhe tolerancën, si dhe vendimmarrjen e përbashkët në komunitet e shoqëri etj.³² Këto njësi mësimore pasohen me detyra në Fletoren e Punës të lëndës Shoqëria dhe Mjedisi, të klasës së tretë, ku nxënësit, nëpërmjet detyrave nxiten të mendojnë dhe të diskutojnë për përkatësitë grupore, për të drejtat dhe përgjegjësitë e njeriut, barazinë dhe diversitetet në komunitet.³³

26. Nga analiza e teksteve mësimore, ndër rastet e gjuhës së urrejtjes më të theksuara janë evidentuar te teksti shkollor Gjuhë Shqipe 6, i shkruar nga autorët Mimoza Gjokutaj, Anila Mullahi, Tereza Babasuli dhe Ragip Gjoshi. Te ky libër ka dy tekste me përmbajtje shumë problematike, të cilat, përveç që janë të pasakta në aspektin historik, përmbajnë gjuhë tipike të urrejtjes ndëretnike dhe të një vetëracizmi kulturor antishqiptar. Te një tekst leximi ku në titull shkruhet “Lexojmë rrëfime popullore”, është vendosur një tekst që përfytyron një dialog mes dy figurash historike të shekullit XIX: prijësit fisnor shqiptar Ali Pashë Gucia dhe prijësit fisnor malazez Mark Milani.

³¹ Diversiteti dhe gjithëpërfshirja sociale - analizë e teksteve shkollore në Kosovë, 2021, në: <https://indeksonline.net/wp-content/uploads/2021/09/Analize-e-teksteve-shkollore-1-3-converted-1.pdf>.

³² Po aty f. 8, 12, 22, 28, 38, 47, 52.

³³ Lindita Lutaj, Dhurata Tara - Nixha. Miranda Stavileci. *Shoqëria dhe Mjedisi 3 - Fletore Pune*, Prishtinë: Dukagjini. 2021, f. 5, 16, 20, 34, 36.

Grimca humoristike

Para leximit

Anekdotat janë tregime të shkurtra, të cilat me një humor të këndshëm e goditës vëhen re dukje të metat e përgjithshme njerëzore, qëndrimet, sjelljet dhe dobësitë e tyre, dukuritë e ndryshme shoqërore. Ato japin një pasqyrim metaforik, por edhe alegorik të realitetit tonë me të cilin përballlemi çdo ditë. Ato janë dëshmi e zgjuarsisë dhe e mendjempërhësisë natyrore të popullit që i tregon. Në to jepen ngjarje reale dhe historike, ndodhi të rryerëve të thjeshtë, por dhe të personaliteteve të njohura etj.

Shqiptarët janë si shqiptet

Në një ndeje në Mal të Zi, Mark Milani i thotë Ali Pashë Gucisë:

– Ju shqiptarët jini sikur dhinë e egra. A i ke parë dhinë e egra, njëra në atë rrepirë, tjetra në rrepirën përballë, thërrasin e bërtasin se nuk u rrihet vetëm, por kur bëhen bashkë, të parën punë që bëjnë, godasin njëra-tjetrën në lule të ballit, veç në këmbë të prapme për të bërë belanë...

Ali Pashë Gucia buzëqeshi e tha:

– E more Mark Milani, me sa di unë, edhe ti prejardhjen e ke shqiptare, por pasi u bërë malazez “të koftë me sherr kombi i ri...” E për dhinë e egra, po them, e ke gabim!

– Pse e kam gabim?

– Sepse shqiptarët nuk janë sikur dhinë e egra, por janë shqiponja. I ke parë buburrecat? Ata janë të vegjël, qyqarë, rrinë bashkë e punojnë bashkë se vetëm nuk ua mban dhe s’ia dalin dot. E shqiptarët sillen sikur shqiponjat. I ke parë shqiponjat në fluturim, i bien qiellit kryq e tërthor e askënd s’e mbajnë afër vetes, sepse ato janë sundimtare të plota të qiellit e nuk ia kanë nevojën kujt për ndihmë.

– Hollë ke qitur Ali Pashë Gucia!...

– Jo, s’thashë gjë të re, o Mark Milani! Shqiptarët prej shqipeve e kanë marrë emrin, e mjerë ata që s’kanë ndenjtur me shqipe, po janë bërë bashkë me buburrecat!



Fjalor

ripiu – këtu, në një qendër të bashkë
ripiu – këtu, në një qendër të bashkë
ripiu – këtu, në një qendër të bashkë
ripiu – këtu, në një qendër të bashkë
ripiu – këtu, në një qendër të bashkë
ripiu – këtu, në një qendër të bashkë
ripiu – këtu, në një qendër të bashkë
ripiu – këtu, në një qendër të bashkë
ripiu – këtu, në një qendër të bashkë
ripiu – këtu, në një qendër të bashkë

Shënime

Mark Milani dhe Ali Pashë Gucia janë dy figura të njohura në histori. Ali Pashë Gucia ishte kundërshtar shumë i fortë i synimeve shoviniste serbe dhe malazeze ndaj tokave shqiptare. Një ndër nismëtarët e themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Mark Milani ka qenë gjeneral dhe shkrimtar malazez. Ai u bë armik i shqiptarëve kur u printe ushtrive serbo-malazeze për të grabitur trojet shqiptare pasi Perandoria Osmane pa shkatërohet.

Figura 11.

27. Ky tekst që pretendohet të jetë një rrëfim popullor, ndonëse i shkurtër, është i mbushur me fjalë të përdorura në zhargon pezhorativ dhe me mosdurim ndëretnik mes malazezëve dhe shqiptarëve. Në këtë dialog janë vendosur fjali ku personazhet, pra Mark Milani dhe Ali Pashë Gucia, përpiqen të tregojnë superioritet etnik ndaj njëri-tjetrit. Fillimisht këtë e bën Mark Milani, duke fyer shqiptarët dhe treguar superioritetin e malazezëve ndaj tyre, teksa thotë: “Ju shqiptarët jini sikur dhinë e egra. A i ke parë dhinë e egra, [...] kur bëhen bashkë, të parën punë që bëjnë, godasin njëra-tjetrën në lule të ballit, veç në këmbë të prapme për të bërë belanë.” Ndërkaq Ali Pashë Gucia ia kthen po duke e goditur në përkatësinë e tij etnike dhe duke treguar superioritetin e shqiptarëve ndaj malazezëve: “E more Mark Milani, me sa di unë, edhe ti prejardhjen e ke shqiptare, por pasi u bërë malazez, të koftë me sherr kombi i ri. E për dhinë e egra, po them, e ke gabim. [...] Sepse shqiptarët nuk janë sikur dhinë e egra, por janë shqiponja. E shqiptarët sillen sikur shqiponjat. I ke parë shqiponjat në fluturim, i bien qiellit kryq e tërthor e askënd s’e mbajnë afër vetes, sepse ato janë sundimtare të plota të qiellit e nuk ia kanë nevojën kujt për ndihmë.”³⁴ Ky dialog, që për më tepër është një përshtatje moderne e një tregimi popullor para 150 vjetësh, është shembulli më flagrant i gjuhës së urrejtjes që është evidentuar gjatë hulumtimit për këtë raport. Kjo pasi në këtë tekst,

³⁴ Mimoza Gjokutaj, A. Mullahi, T. Babasuli, R. Gjoshi, *Gjuhë Shqipe 6*, Prishtinë: Pegi, 2021, p. 33.

për të treguar superioritetin etnik të malazezëve ndaj shqiptarëve, Marku i quan ata “*dhi të egra*”, kurse në anën tjetër, për të treguar superioritetin e shqiptarëve ndaj malazezëve, Aliu i kundërpërgjigjet duke i thënë se “*shqiptarët sillen sikur shqiptonjat [...] nuk ia kanë nevojën kujt për ndihmë*”. Thelbi i mosdurimit ndër-etnik, që e karakterizon këtë tekst, rri te pjesa: “*Të koftë me sherr kombi i ri.*” Tekste si këto me dialogje të tilla plot gjuhë urrejtje, ksenofobi, nacionalizëm agresiv dhe etnocentrizëm, mund të nxisin mendime dhe qëndrime të tilla edhe te nxënësit (shih Figurën 11).

28. Në po këtë libër dhe po te një tekst leximi, ka një tjetër rast po kaq problematik. Është fjala për një tekst të titulluar “*Familja shqiptare dikur dhe sot*”, që përpiqet t’i trajtojë strukturat dhe vlerat e familjes shqiptare sipas traditës dhe historisë së saj. Por autori i tij nuk është historian apo antropolog, si profil përkatës për ta trajtuar familjen shqiptare nëpërmjet trajtave tradicionale dhe në kontekst historik. Përkundrazi, autori i këtij teksti është klerik fetar, gjë që e bën që në fillim këtë tekst të papërshtatshëm për t’u përfshirë në një libër shkollor të një sistemi arsimor publik që është laik, sikur edhe shteti i Republikës së Kosovës. Autori i këtij teksti, siç është shënuar poshtë tij, është Don Lush Gjergji, një prift katolik i respektuar në publik në Kosovë. Megjithatë, përfshirja e një teksti të shkruar prej tij në një libër shkollor do të mundë të përlligjej vetëm nëse do të ishte fjala për ndonjë tekst letrar, siç është rasti me poezitë apo me tekstet e tjera letrare të priftërinjve katolikë shqiptarë dhe të shkrimtarëve të shquar si Gjergj Fishta, Ndre Mjeda etj., të cilat janë shumë të pranishme në tekstet shkollore. Përtej profilit klerikal të autorit në vetvete, ai bëhet problematik për shkak të përmbajtjes shumë konservatore dhe krejtësisht të pasaktë të përmbajtjes së tekstit (shih Figurën 12).

Lexojmë

Familja shqiptare dikur dhe sot

Përa leximit

Familja është vendi më i shtrëngtë për gjithsecilin prej nesh. Ajo duhet të jetë vendi ku gjithsecili prej anëtarëve të saj të gjejë dashurinë e vërtetë dhe përkujdesjen pa interes. Mënyra se si është ndërtuar dhe se si funksionon një familje, përcakton mënyrën se si zhvillohet një shoqëri. Nëse familja është në krizë, edhe shoqëria është në krizë. Familja ka ndikim parësor në krijimin e karakterit të secilit prej nesh dhe, nëse familja është e shëndoshë, individit do të bëhet një qytetar i zoti dhe me vlera.

Familja patriarkale dhe nukleare

Familja shqiptare historikisht ka qenë patriarkale dhe mbështetet në këto tri parime themelore traditore dhe kanonore:

- anëtarët e saj jetonin nën një kulm dhe kishin zotin dhe zonjën e shtëpisë;
- si qëllim jete kishin shtimin e anëtarëve të shtëpisë dhe të familjes nëpërmjet martesës, lindjes së fëmijëve;
- zhvillimi i tyre trupor dhe mendor ishte pika e tretë e këtij synimi.

Familja patriarkale është bashkësi e gjerë njerëzish, në ndryshim nga ajo nukleare apo bërthamorja, me marrëdhënie ndërpersonale burrë-grua-fëmijë, një lloj “kollektivizmi” burimor, ku personi “shkrihet” në logjikën e familjes, pa pasur mundësi për krijimin e personalitetit vetjak dhe të identitetit personal.

Kështu doemos krijohet mentaliteti turmor, grumbullor, masiv, që si parim bazë ka traditën: si të tjerët, si të parët e mi, si të gjithë! Ana tjetër e këtij organizimi familjar është individualizmi i tepruar ose “hajraktarizmi”, që shprehet nëpërmjet nevojës dhe dëshirës për të sunduar të tjerët me parime: vetëm si të them unë, sepse tjetri nënçmohet, nënshtrohet, objektivizohet, nëpërkëmbet dhe keqtrajtohet, te ne sidomos bota femërore dhe fëmijët.

Fjalor

patrishtari — që lidhet me sundimin e pikës në burrë në familje dhe në marrëdhëniet shoqërore

sunduar — si sundues

identitet — vetëdije

masiv — shtet

hajraktarizmi — mënyra e egër dhe paqëndrueshmëri e qëllit në raport me traditën

objektivizim — ligjërimi për të mos uer zhvilluar një shtet të castuar



171

Figura 12

Cfarë i mungon sot familjes shqiptare?

Edukimi për liri dhe për përgjegjësi, për vlera dhe virtyte, me orientime dhe përcaktime të qarta, sepse pa këtë njeriu është "lojë rasti" apo methanash, një lloj "mali" në duart e fatit dhe të të tjerëve.

Edukimi për komunikim, për takime, afrime, bashkime, bisedime, dialog, gjithnjë në kërkim dhe në zbatim të së mirës së përbashkët.

Me mentalitetin turmor njeriu shkrihet në masë anonime, ndërsa me individualizmin e tepruar njeriu shndërrohet në sundimtar; ka rrezik të bëhet gati edhe diktator.

Faza kalimtare mes familjes patriarkale dhe asaj nukleare është mjaft e vështirë dhe me plot sfida dhe rreziqe, sidomos kur rrezimi i sistemit politik, ekonomik, kulturor dhe shoqëror ndodh edhe me luftë, si ishte fatkeqësisht rasti ynë.

Këtë e ka pësuar dhe ende e pëson familja shqiptare, sepse ajo e vjetra, tradicionale, tashmë është dëmtuar dukshëm, gati edhe është shkatërruar në tërësi, kurse e reja, bërthamorja, ende nuk është formuar.

Kohët e fundit, familja gjithnjë e më tepër ngushtohet, sepse pjesa dërmuese e jetës kalohet jashtë familjes, shtëpisë, në punë, në udhetime, në lidhje dhe marrëdhënie me të tjerët, aq sa shtëpia gati është bërë "bujtore".



Në këtë situatë, femrat shqiptare janë vetëdijesuar nëpërmjet shkollimit dhe punësimit se janë pikësepari qenie njerëzore, pastaj femra, qenie familjare dhe shoqërore, dhe si të tilla janë pjesë aktive e familjes dhe e shoqërisë. Ato përfaqësojnë vlerat e mirëfillta të traditës që duhet të ruhen dhe të kultivohen, duke i begatuar edhe me vlera bashkëkohore, si edukimi personal dhe ndërpersonal, bashkëpunimi, bashkëjetesa, toleranca ndërfetare dhe ndëretnike, kultura e punës, e përgjegjësisë dhe e komunikimit.

(Don Lush Gjergji)

Figura 13.

29. Teksti "*Familja shqiptare dikur dhe sot*" përmban pikëpamje dhe opinione kundërthënëse dhe pretendime të pasakta në rrafshin historik (shih figurat 12 & 13). Aty keqinterpretohen konceptet bazë "*familje patriarkale*" dhe "*familje nukleare*", duke i menduar si përjashtuese të njëra-tjetrës dhe duke e përbuzur njërin dhe për ta ngritur tjetrën. Me termin "*familje patriarkale*" qartazi teksti paraqet gabimisht "*familjen e gjerë*" dhe nuk arrin ta shpjegojë që një familje nukleare mund të jetë patriarkale njëkohësisht. Madje, në paragrafin e dytë të faqes pasuese, në tekst shkruhet: "*Faza kalimtare mes familjes patriarkale dhe asaj nukleare është mjaft e vështirë.*" Në hyrje të tekstit shkruhet se "*Familja shqiptare [...] si qëllim jete kishin shtimin e anëtarëve të shtëpisë dhe të familjes nëpërmjet martesës, lindjes së fëmijës.*"³⁵ Ky pohim e redukton familjen shqiptare në një stad parakulturor, ku i tërë qëllimi i jetës është riprodhimi dhe vazhdimësia biologjike si dhe shtimi demografik i grupit. Si i tillë, ky pohim është tipik racist dhe bëhet edhe më shumë i tillë, meqë tutje aty flitet për "*mentalitet turmor, grumbullor dhe masiv*", teksa bëhen përpjekje të pakuptimta për ta shpjeguar mendësinë e familjes shqiptare dhe traditat e saj.³⁶ Në paragrafin pasues, familjes shqiptare i vishen karakteristika klanore shumë primitive përmes pretendimit: "*Ana tjetër e këtij organizimi familjar është individualizmi i tepruar, ose "bajraktarizmi", që shprehet nëpërmjet nevojës dhe dëshirës për të sunduar të tjerët me parime: vetëm si të them unë, sepse tjetri nënçmohet, nënshtrohet, objektivizohet, nëpërkëmbet dhe keqtrajtohet, te ne sidomos bota femërore dhe fëmijët.*"³⁷ Veçanërisht ky paragraf e paraqet familjen shqiptare si një strukturë sociale shumë të paqytetëruar, primitive dhe me zakone barbare, ku njerëzit

³⁵ Mimoza Gjokutaj, A. Mullahi, T. Babasuli, R. Gjoshi, *Gjuhë Shqipe* 6, Prishtinë: Pegi, 2021, p. 171.

³⁶ Nebi Bardhoshi, *Antropologji e Kanunit*, Tiranë: Pika pa Sipërfaqe, 2016, f. 235-260

³⁷ Po aty f.171.

shtypen dhe ku gratë dhe fëmijët objektivizohen dhe keqtrajtohen. Është e tepërt të thuhet se sa të pavërteta janë këto gjykime në rrafshin historik, por edhe në botën aktuale të familjes shqiptare.³⁸ Në të majtë të tekstit është edhe një kuti, ku nën pyetjen “Çfarë i mungon sot familjes shqiptare?”, si përgjigje është shkruar: “Edukimi për liri dhe për përgjegjësi, për vlera dhe virtyte [...]”³⁹, duke e paraqitur familjen shqiptare si të përhumbur dhe me nevojën për t’u edukuar për përgjegjësi, vlera dhe virtyte, që lë të nënkuptohet se familja shqiptare nuk i ka. Ai ofron pikëpamje të paqarta për raportet gjinore, përcjellë paragjykime sociale, riprodhon një diskurs të vjetruar me shumë stereotipa dhe përçon një narracion plot përbuzje për të kaluarën e familjes shqiptare dhe për gjendjen aktuale të saj.

VI. KONSTATIMET

30. Avokati i Popullit, në bazë të vlerësimit dhe të analizimit të teksteve shkollore të arsimit fillor në Kosovë, konstaton se në përgjithësi respektohen standardet për gjuhën e përdorur në tekstet mësimore, kjo për faktin se nga analiza e teksteve shkollore del se ka një prani shumë të vogël dhe krejt të kufizuar të gjuhës së urrejtjes në të gjitha format e manifestimit të saj, siç janë shpjeguar te pjesa për teorinë dhe ligjet mbi gjuhën e urrejtjes. Këto gjetje reflektojnë përpjekjet institucionale dhe shoqërore për rishikimin e teksteve të mëhershme dhe adresimin e tyre drejt mbështetjes së një kulture të tolerancës, barazisë dhe antiracizmit.

31. Avokati i Popullit konstaton se nga gjithsej 47 tekste shkollore të analizuar janë gjetur dy raste më të theksuara të gjuhës së urrejtjes. Kjo tregon një prirje të qëllimshme pozitive për balancë,⁴⁰ për sa u takon përfshirjes dhe shpërndarjes së teksteve të ilustruara dhe personazheve që promovojnë barazinë gjinore si dhe disa tekste e ilustrime të personazheve që përfshijnë persona me aftësi të kufizuara.⁴¹ Megjithatë konsideron se nuk janë paraqitura mjaftueshëm e të balancuar në figura e tekste të gjitha grupet diverse të shoqërisë.

32. Bazuar në të gjeturat nga analiza e teksteve mësimore, rezultojnë se tekstet shkollore të analizuar gjatë këtij hulumtimi në përgjithësi nuk përmbajnë gjuhë diskriminuese mbi baza gjinore, racore, fetare, siç nuk përmbajnë gjuhë tipike të urrejtjes ndaj komuniteteve të caktuara, apo nxitje drejt një gjuhe të tillë.

33. Avokati i Popullit konstaton se nga analiza e teksteve shkollore ka rezultuar që tekstet mësimore që përmbajnë gjuhë të papërshtatshme dhe gjuhë të urrejtjes janë teksti shkollor Gjuhë Shqipe 6, në pjesën “Tekst leximi”, me titull: “Lexojmë rrëfime popullore”; dhe teksti i titulluar “Familja shqiptare dikur dhe sot”.

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.” Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: “[...] ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla [...]”, prandaj i

³⁸ For evolution of Albanian family, see: *Albania: Family, Society and Culture in the 20th Century*, A. Hemming, G. Kera, E. Pandelejmoni, (eds.), Berlin: LIT Verlag, 2012.

³⁹ Po aty f. 172.

⁴⁰ Agron Gashi, S. Kumnova, F. Fejziu, Dh. Tara, *Gjuhë Shqipe 4a*, Pejë: Dukagjini, 2021, p. 76, 155.

⁴¹ Agron Gashi, S. Kumnova, Dh. Tara, F. Fejziu, Pejë: Dukagjini, 2021, *Gjuha Shqipe 3b*, p. 30.

REKOMANDON

Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit:

- 1. Të hartojë një udhëzues për parandalimin dhe eliminimin e gjuhës së urrejtjes, i cili duhet të zbatohet në të gjitha rastet kur hartohen kurrikula dhe tekste shkollore të reja apo rishikohen ato që janë në fuqi.*
- 2. Të bëjë një analizë të plotë të të gjitha teksteve shkollore me qëllim të gjithëpërfshirjes së grupeve diverse dhe shfaqjen e balancuar në tekstet shkollore.*
- 3. Të organizohen trajnime për autorë tekstesh shkollore dhe për mësimdhënës për lirinë e shprehjes, me qëllim të ngritjes së aftësisë dhe të kapaciteteve për eliminimin e gjuhës së urrejtjes gjatë hartimit të teksteve shkollore dhe gjatë mësimdhënies.*
- 4. Të përfshihen njësi të veçanta mësimore në tekstet shkollore për gjuhën e urrejtjes, me qëllim që edhe nxënësit të njihen me konceptet dhe kuptimet bazë si dhe me format e manifestimeve apo të nxitjeve të gjuhës së urrejtjes.*
- 5. Të largohen dy tekstet e evidentuara me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes në librin Gjuhë Shqipe 6 dhe të zëvendësohen me tekste të përshtatshme për natyrën e teksteve shkollore dhe për nivelin klasor.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe në pajtim me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit